



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 2/2/1 i Regj.Themeltar
Nr. 2/2/1 i Vendimit**

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga :

Sokol Binaj	Kryesues
Sandër Simoni	Anëtar
Albana Boksi	Anëtar

në datë 13.7.2021, mori në shqyrtim kërkesën administrative nr. 2/2/1 akti, që u përket palëve:

KËRKUES: **Petrit Bara**

OBJEKTI: Konstatim i cenimit të të drejtës për një proces të rregullit ligjor si rezultat i mosshqyrtimit, brenda një afati të arsyeshëm, të kërkesës drejtuar Gjykatës tuaj me objekt: Shfuqizimin si te papajtueshëm me Kushtetutën dhe KEDNJ, i vendimeve nr. 35, date 23.04.2016 dhe nr. 42, date 29.04.2016 i Komisionit Institucional te Zgjedhjeve; nr. 3462, date 04.07.2016 te Gjykatës Administrative te Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 2899, date 29.09.2016 te Gjykatës së Apelit Administrativ, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 399/1 e vijues të KPC, neni 42 i Kushtetutës se Republikës së Shqipërisë, neni 6/1 i KEDNJ.

Në çështjen administrative:

PADITËS: **Petrit Bara**

I PADITUR: Komisioni i Apelimit pranë Universitetit të Mjekësisë Tiranë.
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve pranë Universitetit të Mjekësisë.

PERSON I TRETË: Universiteti i Mjekësisë Tiranë.
Arben Agron Gjata
Avokatura e Shtetit.

OBJEKTI: Pavlefshmëri e zgjedhjeve për Rektor në U.M.T për shkak të shkeljeve të ligjit. Anullimin e vendimit datë 29.04.2016 të KIZ për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për Rektor U.M.T. Detyrimin e KIZ të nxjerrë një datë të re për zhvillimin e procesit zgjedhor për Rektor në U.M.T dhe përsëritja tërësisht e procesit të votimit për zgjedhjet në postin e Rektorit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, duke përfshirë në procesin e votimit edhe filialet Sarandë dhe Kukës, të cilët padrejtësisht u përjashtuan nga ky proces votimi.
Marrjen e masës së sigurisë të padisë duke pezulluar procesin e dekretimit të UMT.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e RSh, ligji 80/2015, nenet 11/1, 14, 38, 39, 40 e vijues të Rregullores së Zgjedhjeve Nr. 2459/1 Prot, date 15.03.2016, etj.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. Sokol Binaj dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes.

1. Në datë 20.04.2016 janë zhvilluar zgjedhjet për rektor të Universitetit të Mjekësisë, ku paditësi Petrit Bara ka qenë një nga tre kandidatët e përfshirë në këtë proces.

2. Pas mbylljes përfundimtare të procesit të votimit, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve me vendimin nr. 42, datë 29.04.2016 ka shpallur fitues kandidatin Arben Gjata.

3. Në fazën e numërimit të votave paditësi ka pretenduar se ka patur shkelje dhe pavlefshmëri në procedurat e zhvilluara, për këtë arsye e ka ankimuar vendimmarrjen e këtij komisioni.

4. Kërkesa rezulton të jetë refuzuar nga Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) me vendimin nr. 33, datë 22.04.2016. Në vijim, KIZ rezulton të ketë disponuar me vendimin nr. 35, datë 23.04.2016, "mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar", sipas raportit të votave: Arben Gjata 38.3%, Petrit Bara 36.3% dhe Mira Kapisyzi 25.4%.

5. Më datë 23.04.2016, paditësi rezulton të ketë kërkuar nga KIZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për rektor të UMT-së, si edhe caktimin e një date të re të zgjedhjeve, duke përfshirë në votim edhe filialet e Kukësit dhe të Sarandës. Lidhur me këtë kërkesë, KIZ rezulton të ketë disponuar vendimin nr. 36, datë 24.04.2016, për rrëzimin e saj.

6. Mbi rekursin administrativ të paditësit Petrit Bara, Komisioni i Apelit pranë Universitetit të Mjekësisë, rezulton të ketë disponuar vendimin nr. 9, datë 29.04.2016, me të cilin është vendosur mospranimi i tij dhe lënia në fuqi e vendimit nr. 36, datë 24.04.2016 të KIZ.

7. Përfundimisht, KIZ rezulton të ketë disponuar vendimin nr. 42, datë 29.04.2016, me anë të të cilit është vendosur shpallja e personit të tretë, Arben Gjata, fitues i autoritetit drejtues, "Rektor i Universitetit të Mjekësisë".

8. Duke mos qenë dakord me sa më sipër, paditësi Petrit Bara e ka kundërshtuar gjyqësisht këtë vendimmarrje (sipas objektit dhe bazës ligjore të cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi) dhe pas shqyrtimit të çështjes në dy shkallet e gjykimit, të cilat kanë vendosur rrëzimin e kërkesës, paditësi Petrit Bara ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

9. Çështja në Gjykatën e Lartë është regjistruar në nr. 31003-02344-00-2016, datë 16.12.2016, mbi rekursin e ushtruar prej tij kundër vendimit nr. 3462, datë 04.07.2016 të

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr. 2899, datë 29.09.2016 të Gjykatës së Apelit Administrativ, Tiranë.

10. Me kërkesën e regjistruar në Gjykatën e Lartë, me nr.1775 prot, datë 04.05.2018, pala kërkuese Petrit Bara, në referim të neneve 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, nenit 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6/1 i KEDNJ, ka kërkuar konstatimin e cenimit të të drejtës për një proces të rregullit ligjor si rezultat i mosshqyrtimit brenda një afati të arsyeshëm, të çështjes nr. 31003-02344-00-2016.

11. Në kërkesën e tij kërkuesi parashtroi përmbledhtazi se “ *Megjithëse çështja është regjistruar pranë kësaj gjykate që nga muaji tetor 2016 dhe i është drejtuar këtij institucioni disa here për përshpejtimin e shqyrtimit, çështja ende nuk është shqyrtuar. Në kushtet kur vazhdon mosshqyrtimi i kësaj çështje, brenda një afati të arsyeshëm, (kjo dhe për shkak të natyrës së mosmarrëveshjes, pasi kanë kaluar dy vjet nga mandati 4-vjeçar i rektorit të zgjedhur dhe çdo vendimmarrje e mëvonshme humbet efektet dhe vlerën e dhënies së drejtësisë, si dhe me qëllim që kjo drejtësi e vonuar mos jete një drejtësi e mohuar), kërkohet që bazuar në Urdhërin nr. 284, datë 06.07.2017 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, marrjen e masave për përshpejtimin e procedurave për shqyrtimin e saj. Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm i çështjes është detyrim i gjykatave shqiptare, në referim të nenit 399/1 e vijues të KPC, neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6/1 i KEDNJ. (...) Mosgjykimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm është konsideruar nga GJEDNJ si shkelje e të drejtave dhe garancive të parashikuara nga KEDNJ. madje në rastet kur një shtet ka pasur shkelje të gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm për shume çështje, kjo është konsideruar si rrethane renduese. në rast të shkeljes së kësaj garancie shteti ka detyrim pozitiv të marrë masa të përgjithshme për reformimin e institucioneve të tij dhe procedurave gjyqësore.”.*

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) konstaton se kërkesa është paraqitur nga një subjekt i legjitimuar. Kërkuesi Petrit Bara, rezulton të jenë në cilësinë e palës paditëse në procesin gjyqësor për të cilin është regjistruar çështja (mbi rekursin e Tij) me nr. 31003-02344-00-2016, datë 16.12.2016, në Gjykatën e Lartë.

17. Kërkesa është në kompetencën e këtij Kolegji, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “c”, të Kodit të Procedurës Civile, pasi përmes saj kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë. Kërkesa i plotëson elementët e parashikuar në nenin 399/5, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile si dhe është e shoqëruar me të gjitha aktet e tjera të nevojshme, të përcaktuar në nenin 399/5, pika 2, të Kodit të Procedurës Civile.

18. Kolegji vlerëson se parimi i gjyqimit brenda afatit të arsyeshëm ka një rëndësi themelore për gjykimin civil/administrativ, pasi përbën dhe një nga elementët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky parim bazohet në postulatën “*Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar*”. Shkalla e respektimit të këtij parimi përcakton në mënyrë të ndjeshme dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. (*Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ*)

19. Kolegji çmon të theksojë praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), e cila ka përcaktuar se periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. (*shih vendimin Qufaj kundër Shqipërisë; Vendimin Scopelliti kundër Italisë, datë 23.11.1993 të GJEDNJ*). Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjyqimit të çështjes.

20. Në vijim, të jurisprudencës së konsoliduar GJEDNJ ka identifikuar disa elemente përbërëse të këtij standardi. Në referim të saj, rezulton se në përlogaritjen e afatit të arsyeshëm merren në konsideratë faktorë të ndryshëm, të tilla si: kompleksiteti i çështjes; sjellja e palëve ndërgjyqëse; sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative. (*Shih vendimin Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane datë 06.05.1981 dhe Bjeliç kundër Sllovenisë ap. nr. 50719\06, datë 18.10.2012. të GJEDNJ*)

21. Kolegji vlerëson se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes, merr në konsideratë të gjithë faktorët dhe elementet që kanë të bëjnë me çështjen, natyrën e interesave të përfshira në të, rëndësinë e fakteve, rëndësinë e zgjidhjes ligjore, numri i personave të akuzuar dhe i dëshmitarëve, elementet ndërkombëtarë, lidhja e çështjes me çështje të tjera dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedure. (*Shih vendimin Trggiani kundër Italisë datë 19.02.1991; Manieri kundër Italisë dt. 27.02.1992, Stefancic kundër Sllovenisë, datë 25.10.2012 të GJEDNJ*)

22. Për sa i përket sjelljes së kërkuesit, Kolegji çmon se ky kriter lidhet me mënyrën se si janë sjellë palët në proces ndaj procedimit. Diligjencën e treguar prej tyre për përfundimin e procesit, pengesat që ato kanë krijuar dhe faktorë të tjerë që janë të lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti vlerëson gjykata, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet proceduese në mënyrë aktive për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që çojnë në dënimin e tij. (*shih vendimin Eckkle kundër Republikës Federale Gjermane, dt. 15.07.1982 të GJEDNJ*)

23. Kolegji vlerëson se për sa i përket sjelljes së autoriteteve për vlerësimin e kohëzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, GJEDNJ ka vlerësuar se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të merren parasysh. Këto vonesa mund të shkaktohen ose nga autoritetet gjyqësore ose nga autoritetet administrative. Shkaqë të kësaj natyre në jurisprudencën e GJEDNJ janë vënë në dukje si p.sh.: bashkimi i gabuar i disa çështjeve që ka shkakuar vonesa të panevojshme, shtyrjet e pabazuara në ligj të seancave gjyqësore, pezullimi i kundërligjshëm i procesit gjyqësor, vonesat nga ana e agjencive publike ligjzbatuese të shtetit në dorëzimin e provave të kërkuara nga gjykata, transferimi i çështjeve penale nga një gjykatë në tjetrën, mbajtja e seancave të apelimeve. (*Shih vendimin Ewing kundër Mbretërisë së Bashkuar*)

24. Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji konstaton se në momentin e regjistrimit të kërkesës në Gjykatën e Lartë çështja me nr. 31003-02344-00-2016, kishte rreth 1 vit e 6 muaj që ishte regjistruar pranë kësaj gjykate.

25. Duke marrë në vlerësim standardet e përcaktuar nga jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me afatin arsyeshëm nuk rezulton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar, të jetë shtyrë gjykimi për shkak të kërkesave të palës kërkuese. Çështja nuk paraqitet shumë komplekse nga natyra e saj, pasi ka natyrë të pastër administrative, kundërshtohet vendimmarrja e një organi administrativ. Nga ana tjetër, nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit.

26. Kolegji vlerëson të theksojë se vonesa e gjatë në shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete objekt gjykimi, është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Përbën një fakt të njohur botërisht se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh në Republikën e Shqipërisë. Ky proces natyrisht ka krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore. Këto vështirësi janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme që padyshim krijon procesi i reformës.

27. Komisioni i Venecias ka theksuar se reforma në drejtësi, procesi i verifikimit të gjyqtarëve/prokurorëve në Shqipëri, ishte e domosdoshme edhe nëse do të sillte pasoja të paparashikuara. Përveç aspekteve të padyshimta pozitive mbi cilësinë e gjyqësorit në planin

afatgjatë, në një periudhë afatshkurtër procesi i verifikimit ndikon në numrin e gjyqtarëve aktiv në sistem duke shkaktuar problem të përkohshme praktike derisa të bëhet zëvendësimi i tyre (*Shih European Commission for Democracy through law (Venice Commission) Albania opinion on the appointment of judges to the Constitutional Court*).

28. Kolegji vlerëson se rrethanat e mësipërme janë pasur në vëmendje edhe nga ligjvënësi në kohën e miratimit të ndryshimeve ligjore, konkretisht me ligjin nr. 38/2017 të Kodit të Procedurës Civile duke parashikuara Kreun X “Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”. Neni 399/2 pika 3 e Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, **ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.**”. Kolegji çmon se legjislatori me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile ka parashikuar shprehimisht rrethanat e pamundësisë objektive për llogaritjen e afateve në kohëzgjatjen e gjykimit si një shkak objektiv që shkarkon nga përgjegjësia për tejkalimin e afatit të fiksuar në nenin 399/2 pika 2 të Kodit të Procedurës Civile.

29. Kolegji vlerëson se në rastin konkret, nga momenti i regjistrimit të rekursit/çështjes në Gjykatën e Lartë, ka rezultuar se gjyqtari relator është ndryshuar disa herë, kjo, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, për shkak të plotësimit të Gjykatës së Lartë me gjyqtarë të tjerë apo për shkaqe të tjera objektive të parashikuara nga ligji. Pas rishortimit të fundit të çështjeve me datë 25.4.2020, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen dhe me vendimin nr. 169 (21), datë 24.2.2021 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. 2899, datë 29.09.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë, me trup tjetër gjykses.

30. Për sa më sipër, Kolegji çmon se duhet të vendoset pushimi i kërkesës pasi çështja është marrë në shqyrtim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë dhe ka përfunduar me vendimin e cituar më lart.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe nenit 399/7 pika 3 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Pushimin e gjykimit të kërkesës.

Tiranë, më 13.07.2021

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

Sandër SIMONI

Albana BOKSI

Sokol BINAJ